
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“EAGLESFOOD” Sh.p.k.**

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“EAGLESFOOD” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“EAGLESFOOD” Sh.p.k.** dhe me emer tregtare **“EAGLESFOOD”**, zoterohet nga ortaket:

- 1. Shoqeria e Huaj e emertuar TOSCOFOOD SRL**, shoqeri e te drejtes italiane e regjistruar me numer regjistrimi 01838990479, me adrese te selise Piazza della Resistenza, 4-51010 Massa E Cozzile (PT), Itali.
- 2. Shoqeria shqiptare e emertuar FI. ME. GI. SHPK**, shoqeri e regjistruar me NIPT : M42120024I, me adrese te shoqerise Rruga Norbert Jokl, Ndertesa Nr. 2, hyrja Nr.1, Njesia Administrative Nr. 2, Tirane
- 3. Z. Joan Malshi**, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhe, me 26.07.1992 dhe rezident ne Zejemen, Pllane, Lezhe, i identifikuar nga pashaporta me nr. J20726041O.

Në përputhje me vullnetin tone te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosem të hartojmë këtë akt themelimi të shoqërisë **“EAGLESFOOD” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **“EAGLESFOOD” Sh.p.k.**

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Norbert Jokl, Ndertesa Nr. 2, Hyrja 1, Njesia Administrative Nr. 2, Tirane, Albania.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**EAGLESFOOD**” Sh.p.k ka si objekt aktivitetin e përpunimit, konservimit dhe tregtimit të ullinjve dhe produkteve të ngjashme ushqimore. Veprimtaritë kryesore të shoqërisë përfshijnë:

1. Përpunimin dhe konservimin e ullirit në produkte të ndryshme për konsum të brendshëm dhe të jashtëm.
2. Importin dhe eksportin e ullinjve dhe produkteve të ngjashme si vaj ulliri, ullinj të konservuar, dhe produkte të tjera ushqimore të përpunuara, përfshirë domate të konservuara dhe perime të tjera.
3. Tregtimin me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore të përpunuara, në Shqipëri dhe jashtë saj.
4. Shërbime këshillimi dhe zhvillimi për sektorin e ushqimeve të konservuara dhe të vajit të ullirit.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me ligjet e shtetit shqiptar dhe legjislacionin ndërkombëtar, duke respektuar standardet më të larta të cilësisë për produkte të përpunuara dhe të konservuara.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 1,000,000 Leke (nje milion Leke) ose i konvertuar ne monedhe te huaj 10,000 euro (dhjete mije euro), i ndare në 3 (tre) pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

- 1. Shoqeria e Huaj e emertuar TOSCOFOOD SRL**, shoqeri e te drejtes italiane e regjistruar me numer regjistrimi 01838990479, me adrese te selise Piazza della Resistenza, 4-51010 Massa E Cozzile (PT), Itali. e cila zoteron 1 (nje) kuote ne vleren 100,000 leke (nje qind mije) e cila perfaqeson 10% te kuotave te kapitalit te shoqerise.
- 2. Shoqeria shqiptare e emertuar FI. ME. GI. SHPK**, shoqeri e regjistruar me NIPT : M42120024I, me adrese te shoqerise Rruga Norbert Jokl, Ndertesa Nr. 2, hyrja Nr.1, Njesia Administrative Nr. 2, Tirane, e cila zoteron 1 (nje) kuote ne vleren 300,000 leke (tre qind mije) e cila perfaqeson 30% te kuotave te kapitalit te shoqerise.
- 3. Z. Joan Malshi**, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhe, me 26.07.1992 dhe rezident ne Zejemen, Pllane, Lezhe, i identifikuar nga pashaporta me nr. J20726041O, i cili zoteron 1 (nje) kuote ne vleren 600,000 leke (gjashteqind mije) e cila perfaqeson 60% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk eshte ortak. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “**EAGLESFOOD**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare, eshte emeruar:

Joan Malshi, te cilit i besohen te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe i identifikuar me pashaporte me Nr. ID. J20726041O.

NENI 9
DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tirane.


Ky akt themelim është hartuar në 4 (kater) ekzemplare, 2 (dy) ne gjuhen shqipe dhe 2 (dy) ne gjuhen italiane duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 15.10.2024

ORTAKET E SHOQERISE
“EAGLESFOOD” Sh.p.k.


Per shoqerine
TOSCOFOOD

(perfaqesuesi sipas vendimit te ortakut)



Per shoqerine
FI. ME. GI SHPK

(perfaqesuesi sipas vendimit te ortakut)



Z. Joan Malshi

